



БОРБА
ПРОТИВ
ТОРТУРА И
НЕХУМАН
ТРЕТМАН

RAPORT MBI GJENDJEN DHE KUSHTET NË INSTITUCIONET NDËSHKIMORE -KORREKTUESE NË VITIN 2023

në bazë të vizitave vijuese në
SHNK Idrizovë, SHNK Shtip,
SHNK Prilep dhe Burgun Kumanovë,
për periudhën maj - qershor 2023

SHKUP, 2023



Ky projekt
financohet nga
Bashkimi Evropian



KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT



МЗМП

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
i përfaqësuar nga Prof. Dr. Neda Zdraveva

Autorë:

Tona Kareva Taleska

Redaktore:

Doc. Dr. Elena Mujoska Trpevska

Lektore:

Violeta Tançeva-Zlateva

Përkthimi në shqip:

Shenasi Jaji

Viti i botimit:

2023

Vendi i botimit:

Shkup

Numri i faqeve:

28

Dizajni grafik:

Masiva Creative Agency

Tirazhi:

100 ekzemplarë



Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
ORARI I VIZITAVE	6
RRETH PROJEKTIT	7
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE IDRIZOVË	9
Pavijoni / reparti i grave	11
Kujdesi shëndetësor	12
Ndihma juridike	13
Rekomandime	13
Gjendja e krizës	15
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE SHTIP	17
Kujdesi shëndetësor	19
Ndihma juridike	19
Rekomandime	20
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE PRILEP	21
Kujdesi shëndetësor	22
Ndihma juridike	23
Rekomandime	23
BURGU KUMANOVË	25
Kujdesi shëndetësor	26
Ndihma juridike	27
Rekomandime	27

HYRJE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Lufta kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor”, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Për qëllime të projektit është lidhur memorandum për bashkëpunim në mes të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Në periudhën nga muaji maj deri në muajin qershor të vitit 2023, janë realizuar katër vizita të njëpasnjëshme në SHNK Idrizovë, SHNK Shtip, SHNK Prilep dhe Burgun e Kumanovës, bazuar në vlerësimin e ekipit që është përfshirë dhe punon në projekt. Përzgjedhja e institucioneve të vuajtjes së dënimit është për shkak të kushteve të shqyrtuara për akomodimin e personave të dënuar të konstatuara gjatë vizitave të rregullta, por edhe nga indikacionet dhe peticionet e shumta të dorëzuara nga personat e dënuar në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

Gjetjet në këtë raport bazohen në të dhënat e marra nga vizitat e kryera nga grupi monitorues, i cili ka inspektuar ambientet e institucioneve ndëshkimore-korrektuese, ka ofruar asistencë ligjore falas, ka zhvilluar biseda me pothuajse të gjithë drejtuesit e institucioneve, si dhe me punonjës të policisë së burgjeve, punonjës socialë, psikologë, avokatë etj.

Është konstatuar se, përkundër angazhimeve të shumta të shtetit, organizatave ndërkombëtare dhe vendase për përmirësimin e kushteve në institucionet e vuajtjes së dënimit, megjithatë ekzistojnë ende mangësi. Është evidente dhe e qartë se mungon bashkëpunimi i duhur ndërsektorial ndërmjet institucioneve kompetente, i cili është kyç për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen personat e privuar nga liria në këto institucione. Pikërisht për këtë arsye, institucionet e vuajtjes së dënimit nuk përmbushin detyrimet e tyre ligjore për tejkalimin e problemeve të zgjatura prej kohësh dhe pamundësojnë personat e dënuar të gëzojnë të drejtat e tyre dhe të risocializohen në mënyrë adekuate.

Personat e dënuar nuk kanë qasje adekuate në kujdesin shëndetësor, as kushte adekuate materiale të jetesës dhe programet e risocializimit, kushtet për zbatimin e tyre, kurse ndihma pas vuajtjes së dënimit është ende e pamjaftueshme dhe e pazbatueshme. Njëkohësisht, gjatë kësaj periudhe ka pasur një rritje të pakënaqësisë së pjesëtarëve të policisë së burgjeve, të cilët theksuan se u cenohej siguria dhe se po përballeshin me një problem serioz për shkak të rritjes së presioneve dhe kërcënimeve personalisht ndaj tyre, por edhe ndaj familjeve dhe personave të afërm të tyre.

Korrupsioni vazhdon të jetë problem serioz në këto institucione, për të cilin personat e dënuar na informojnë rregullisht. Por nga frika se mos humbasin të drejtat dhe komoditetet e tyre, ata nuk duan t'i raportojnë zyrtarisht këto raste. Po ashtu, ajo që është vënë re dhe që është veçanërisht shqetësuese është numri i vogël i ankesave të parashtruara nga personat e dënuar për vendimet e marra për shqiptimin e masave disiplinore. Praktika tregon raste kur personat e dënuar nuk kanë marrë vendime përkatëse për shqiptimin e masës disiplinore. Për shembull, nëse ndodhen në izolim, vendimi ngjitet në derën e izolimit, kurse personat e dënuar, kontaktin me një organizatë joqeveritare, jurist dhe/ose avokat mund ta arrijnë vetëm pasi të kenë mbaruar vuajtjen e masës disiplinore. Të gjitha institucionet nuk e respektojnë procedurën e rregullt formale për shqiptimin e masës disiplinore, kështu që në disa raste nuk është marrë as vendim për shqiptimin e masës disiplinore. Si praktikë pozitive vërehet se në disa institucione të vuajtjes së dënimit po bëhen përpjekje për vendosjen e masave dhe aktiviteteve risocializuese, aktiviteteve profesionale, si dhe rritjes së angazhimit në punë të personave të dënuar.

Mbipopullimi, veçanërisht në SHNK Idrizovë, ku gjendet numri më i madh i personave të dënuar, shumica e të cilëve paraqesin rrezik për sigurinë, është një problem alarmant për të cilin shteti duhet urgjentisht të gjejë zgjidhje. Vetëm me zgjidhjen e këtij problemi sistematik mund të presim realizimin e risocializimit si një nga synimet kryesore të dënimit me burg dhe uljen e shkallës së krimit në vend. Vitet e fundit ka pasur një rritje të rasteve dhe lëndëve të probacionit për të cilat është shqiptuar dënim alternativ, që sigurisht është një nga shembujt pozitivë të zgjidhjes së problemit afatgjatë të mbipopullimit në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe nxitjes së risocializimit dhe riintegrit të personave të dënuar.

Për këtë qëllim, organizatat e shoqërisë civile do të monitorojnë nga afër zbatimin e Strategjisë Nacionale për Zhvillimin e Sistemit Penitenciar në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2025, si dhe të Strategjisë për zhvillimin e Shërbimit të Probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2025. Me zbatimin e këtyre strategjive presim zbatimin korrekt të rregulloreve ligjore dhe nënligjore, përmirësimin e kushteve dhe situatës në burgje, por edhe forcimin e kapaciteteve dhe profesionalizmit të stafit të punësuar, si dhe rritjen e mbikëqyrjes në lidhje me funksionimin e institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe në të njëjtën kohë dhe avancimin e sistemit të probacionit.

ORARI I VIZITAVE

DATA	INSTITUCIONI NDËSHKIMOR -KORREKTUES	EKIPI
29.06.2023	SHNK Idrizovë	Tona Kareva Taleska dhe Ina Xhugumanova
30.05.2023	SHNK Shtip	Tona Kareva Taleska dhe Irena Zdravkova
29.06.2023	SHNK Prilep	Tona Kareva Taleska dhe Irena Zdravkova
09.06.2023	Burgu Kumanovë	Tona Kareva Taleska dhe Irena Zdravkova

RRETH PROJEKTIT

Projekti “Lufta kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor” zbatohet në partneritet me Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj, dhe mbështetet financiarisht nga Bashkimi Europian. Qëllimi kryesor është eliminimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor në burgjet, institucionet edukative-korrektuese dhe spitalet psikiatrike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Qëllimet konkrete janë:

1. Të inkurajohen personat e dënuar, personat e privuar nga liria dhe pacientët në institucionet psikiatrike të raportojnë torturën dhe trajtimin çnjerëzor të pësuar dhe të kërkojnë kompensim për të;
2. Të rritet përgjegjësia e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të torturës dhe trajtimit çnjerëzor; dhe
3. Të forcohen kapacitetet e institucioneve për identifikimin dhe parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor.

Grupet e synuara në kuadër të projektit janë personat e dënuar, personat e privuar nga liria, fëmijët në konflikt me ligjin dhe pacientët në institucionet psikiatrike.

Në kuadër të projektit janë paraparë disa aktivitete, përkatësisht: ofrimi i ndihmës juridike, përgatitja e materialeve edukative për personat e vendosur në institucionet psikiatrike, organizimi i sesioneve informuese për të drejtat e personave të dënuar dhe personave të vendosur në institucionet psikiatrike, përfaqësimi strategjik, monitorimi i institucioneve ndëshkimore-korrektuese, institucioneve edukative-korrektuese dhe psikiatrike, monitorimi i punës së prokurorisë publike për ndjekjen penale të krimeve të kryera nga policia dhe pjesëtarët e policisë së burgjeve, seanca edukative për avokatë dhe punonjës socialë në institucionet penale, mbështetje për miratimin e akteve nënligjore.

Rezultatet e pritshme në kuadër të projektit janë:

- 200 persona të dënuar (10% e popullsisë së burgosur) kanë marrë ndihmë juridike;
- 20 persona të dënuar kanë paraqitur kërkesa për torturë dhe trajtim çnjerëzor;
- Janë mbajtur 8 sesione informuese për të drejtat e personave të dënuar dhe personave të vendosur në institucionet psikiatrike; 6 procedura strategjike të iniciuara; 4 raporte të përgatitura dhe të publikuara me gjetje dhe rekomandime nga vizitat e rregullta dhe vijuese në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe institucionet psikiatrike; 50 punonjës nga institucionet ndëshkimore-korrektuese kanë marrë pjesë në trajnime për identifikimin dhe parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor, nga të cilët 20 kanë marrë pjesë në trajnime të avancuara në këtë fushë; dhe 4 akte nënligjore të përgatitura lidhur me të drejtat e personave të privuar nga liria.

SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE IDRIZOVË

Vizita nisi me një bashkëbisedim me drejtorin e SHNK Idrizovë. Objekti ka kapacitet për të akomoduar 900 persona të dënuar. Shtëpia ndëshkimore-korrektuese Idrizovë në momentin e vizitës kishte gjithsej 1149 persona të dënuar, 65 prej të cilëve femra. Institucioni edhe një herë po përballet me mbipopullim për shkak të numrit të madh të personave të dënuar.

Në këtë institucion janë të punësuar gjithsej 274 persona, nga të cilët 220 janë pjesëtarë të policisë së burgjeve dhe 24 punonjës administrativë. Në sektorin e risocializimit janë të punësuar 28 persona. Policia e burgjeve ka shprehur pakënaqësi të përgjithshme për mungesën e pajisjeve të reja, kurse pajisjet që disponojnë momentalisht janë të pamjaftueshme (uniformë, shkopinj, radiolidhje, pranga etj.). Përveç kësaj, siguria është një problem serioz për ta, sidomos duke pasur parasysh ngjarjet e fundit me djegien e automjeteve dhe arratisjet. Ata treguan se përballet me presione dhe kërcënime të përditshme, si personalisht, por edhe përmes familjeve dhe njerëzve të tyre të dashur.

Gjatë kësaj vizite, duke marrë parasysh se është vizitë vijuese, kemi vizituar pavijonin e mbyllur dhe atë të grave.

Objektet "Ndërtesa" dhe "Ambulanca" përbëjnë repartin e mbyllur të institucionit më të madh ndëshkimore-korrektues SHNK Idrizovë. Përsëri, përkundër vërejtjeve të shumta nga organizatat e shoqërisë civile dhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve të Tjera Mizore dhe Çnjerëzore (CPT), nuk janë vërejtur ndryshime pozitive në këto dy objekte. Personat e dënuar vazhdojnë të vuajnë dënimin me burg në kushte substandarde, me lagështi të lartë dhe prani të çimkave dhe insekteve të tjera, nga të cilat personat e dënuar kanë pickime të shumta. Higjiena në pavijonin e mbyllur është në nivel të ulët të palakmueshëm. Në objektin "Ndërtesa" disa nga dhomat akomodojnë 10-12 persona me shtretër në 3 ose 4 kate (nga kati i tretë dhe i katërt ndodh shpesh që të dënuarit të rrëzohen duke fjetur) dhe dhomat nuk i përmbushin standardet as në për nga madhësia dhe as për sa i përket kushteve materiale, lagështisë dhe dritës. Gjithashtu, në dhomat ishin disa njerëz që flinin përtokë dhe ne gjetëm një situatë ku disa të dënuar nuk kishin dyshek. Për krahasim, në disa dhoma të këtij objekti, personat e tjerë të dënuar

vendosen në pozitë më të favorshme, me faktin se në dhomë me madhësi të njëjtë, një numër më i vogël i personave e vuajnë dënimin, në kushte dukshëm më të mira. Ndonëse, siç u informuam, pas ndërrimit të drejtorit, shumica prej gati 30 personave që flinin në dysheme mbi dyshekë janë vendosur në dhoma, megjithatë, kemi vërejtur disa persona që nuk kishin shtrat dhe flinin në dyshemetë e korridoreve. Një tablo e tillë vërteton se mbipopullimi është ende një problem i pazgjidhur në këtë institucion, i cili vazhdon prej vitesh. Higjiena në tualete është në nivel të ulët, gjë e cila është e pritshme duke pasur parasysh numrin e njerëzve që i përdorin ato.

Në këtë pjesë të institucionit janë konstatuar vërejtje të shumta jo vetëm për kushtet materiale, por edhe për ushqimin, që sipas të dënuarve u jepet një herë në ditë. Për shkak të pakënaqësisë me cilësinë e tij, personat e dënuar që kanë mundësi të përballojnë, marrin ushqim që u dërgohet nga të afërmit e tyre. Po ashtu, personat e dënuar janë ankuar edhe për cilësinë e ujit, të cilin në mënyrë të pavarur e kemi verifikuar se është i turbullt, kështu që janë të detyruar të sigurojnë vetë ujë të ambalazhuar. Përsëri kemi konstatuar praninë e thikave dhe takëmeve të tjera në të gjitha dhomat, për faktin se në SHNK Idrizovë nuk ka dhomë ngrënie. Vazhdon të jetë një problem serioz, sepse në departamentin e mbyllur janë të dënuarit me rrezikshmërinë më të lartë të sigurisë në vend, të cilët shpesh përdorin objekte të mprehta në debate verbale dhe fizike me njëri-tjetrin, por edhe ndaj efektivëve të policisë së burgjeve gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare.

Në ambientet e mbyllura në “Ndërtesa” ndodhen edhe dhomat e izolimit, të cilat janë gjetur në kushte nën standarde, me lagështi të lartë dhe higjienë të ulët, pa mundësi ajrimi të dhomës me ajër të pastër, në të cilat nuk ka mjaftueshëm as dritë natyrale, por as artificiale. Bisedojmë me dy persona në mënyrë të rastësishme të cilët vuanin masën disiplinore të izolimit dhe për këtë arsye janë vërtetuar konkluzionet për kushtet materiale të izolimit nga raportimet e mëparshme. Vendimet për caktimin e masës disiplinore nuk u dërgohen atyre dhe u ngjiten në derën e ambienteve nga jashtë, kështu që personat e dënuar nuk kanë mundësi të bëjnë kundërshtim/ankesë. Në periudhën nga 1 janari deri më 30 qershor janë ngritur 248 procedura disiplinore dhe janë shqiptuar masa disiplinore në numrin më të madh të rasteve për posedim ose përdorim të celularit, drogës, alkoolit apo gjërave të tjera të paligjshme, pastaj për arratisje, sulm fizik, sjellje agresive, sjellje e vrazhdë, abuzim me privilegjet, shkaktim i

dëmit dhe shumë të tjera.

Kushtet nën standarde për sa i përket lagështisë dhe kushteve materiale vërehen edhe në repartin e pritjes në këtë institucion, ku personat e dënuar mbahen më gjatë se sa duhet për shkak të mbipopullimit, por edhe për shkak të procesit të gjatë të vlerësimit profesional nga ekipi kompetent në institucion.

Në objektin e quajtur “Ambulanca” dhe në objektin “Ndërtesa” lagështia është e pranishme në të gjitha dhomat, higjiena dhe aroma janë në nivelin më të ulët, prandaj nevojitet rikonstruksioni i tyre i plotë, ose mbyllja e tyre dhe ndërtimi i një objekti të ri për të siguruar kushte adekuate.

Gjatë vizitës, ekipi përsëri theksoi nevojën e zhvendosjes së një numri të caktuar të personave të dënuar nga institucioni ndëshkimor-korrektues në një nga institucionet psikiatrike, për të marrë kujdesin e duhur shëndetësor për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.

Krahas punësimit standard të të dënuarve në kujdestari, higjienë, lavanteri, kuzhinë etj., të dënuarit në institucionin më të madh ndëshkimor-korrektues më të madhe në vend nuk kanë kushte dhe programe për formim profesional dhe kalim cilësor të kohës së lirë.

Duke marrë parasysh kategorinë e personave që vuajnë dënimin në pavijone të mbyllura, shteti duhet të bëjë përpjekje të veçanta për të krijuar një atmosferë të mirë të brendshme. Është në interes jo vetëm të trajtimit human të personave të dënuar në pavijon/repart, por edhe të ruajtjes efikase të kontrollit, sigurisë dhe sigurisë së personelit.

Pavijoni / reparti i grave

Në këtë pjesë të objektit gjendja nuk ka ndryshuar që nga raporti i fundit. Disa pjesë janë rinovuar dhe rikonstruktuar me dysheme të re dhe dritare, dyer dhe panele diellore të reja PVC, duke përmirësuar kështu kushtet materiale për gratë e dënuara. Por, problem vazhdon të mbetet lagështia në ambiente e cila është e dukshme dhe e përhapur.

Kabina telefonike në repartin e grave është funksionale. Personat e dënuara gra, përveç hapësirës së hapur në të cilën ka një stol me karrige, nuk disponojnë kushte shtesë për argëtim, sport dhe aktivitete profesionale. Ata kanë në dispozicion edhe tableta për komunikim me

familjet, por nuk përdoren shpesh. Në pavijonin e grave nuk ka as një dhomë të përshtatshme në të cilën të dënuarat femra mund të kenë kontakt me fëmijët e tyre, një dhomë që duhet të ofrojë një atmosferë çlodhëse dhe rekreative.

Të dënuarat femra ankoreshin për shpërndarjen e papërshtatshme të të dënuarve në repartin e mbyllur kundrejt atij gjysmë të hapur dhe të hapur, për këtë arsye në institucion ka padurim dhe pakënaqësi. Më saktësisht, disa të dënuara gra që duhet të vendosen në pavijonin e mbyllur vendosen në atë gjysmë të hapur dhe anasjelltas.

Problemi i mos kryerjes së kontrolleve dhe shërbimeve të rregullta gjinekologjike vazhdon të jetë shkelje e rëndë e të drejtave të tyre elementare, për të cilat përgjegjëse është Ministria e Shëndetësisë.

Gjithashtu, gjatë vizitës konstatuam segregimin e grave të dënuara rome, për faktin se të gjitha gratë rome ishin vendosur në një dhomë në repartin e mbyllur, në të cilin konstatoheshin kushtet më të rënda, madje vetëm në atë dhomë nuk kishte televizor.

Kujdesi shëndetësor

Kujdesi shëndetësor në institucion ofrohet nga 1 mjek dhe 2 infermiere, të cilët e vizitojnë institucionin vetëm për disa orë gjatë ditës, gjë që nuk mjafton për një institucion me mbi 1000 persona të dënuar.

Është e nevojshme ofrimi i terapisë me buprenorfinë dhe metadon për të gjithë ata që kanë nevojë për të vazhduar trajtimin e personave të dënuar pa ndërprerje për asnjë arsye, përfshirë edhe zbatimin e parakohshëm të procedurës së tenderit nga Ministria e Shëndetësisë. Në këtë mënyrë do të parandalohet “tregu i zi”, dhuna, stresi dhe pasoja të tjera psikologjike e somatike.

Institucioni na informoi se përballen me borxhe të mëdha lidhur me kujdesin shëndetësor, si rezultat i faturave nga institucionet mjekësore ku po marrin kujdesin shëndetësor personat e dënuar dhe sërish për shkak të mundësive të vështira për organizimin e ekzekutimeve, nuk po marrin kujdes adekuat shëndetësor.

Për më tepër, diabetikët nuk pajisen me shirita për të matur nivelet e sheqerit në gjak dhe jeta e tyre është në rrezik, pasi ata përcaktojnë sasinë

e insulinës që u nevojitet me gjykimin e tyre.

Ministria e Shëndetësisë duhet të sigurojë kujdes adekuat shëndetësor për personat e dënuar. Duke marrë parasysh implikimet financiare që rrjedhin nga referimet në objektet shëndetësore dhe faturat për shërbime të kujdesit shëndetësor për personat e dënuar për institucionet e sistemit penitenciar, shteti duhet të gjejë një mënyrë alternative për të ofruar kujdes adekuat shëndetësor, i cili do të ofrohet në institucion ose do të kontraktohen partneritetet publiko-private për ofrimin e kujdesit shëndetësor.

Ndihma juridike

Gjatë vizitës në SHNK Idrizovë kemi biseduar me 17 persona të dënuar. Arsyet më të zakonshme për të cilat personat e dënuar në këtë institucion kanë kërkuar këshilla juridike kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor, kushtet materiale, takimin me fëmijët dhe partnerin jashtëmartesor, cilësinë e ushqimit dhe ujit, të drejtën e lirit me kusht, transferimin në një institucion tjetër të vuajtjes së dënimit dhe realizimin e të drejtës së vizitës. Disa nga të dënuarit u ankuan se ishin viktimat të korrupsionit dhe se në institucion mund të blihet gjithçka me para: krevat, dyshek, telefon, ujë të ngrohtë, terapi mjekësore, transferim në një institucion tjetër, shfrytëzim ambientesh etj. Një numër i madh i të dënuarve u ankuan se për shkak të mungesës së personelit të mjaftueshëm mjekësor, nuk mund të arrinin në radhën e tyre për ekzaminim.

Rekomandime

- Marrja e masave për eliminimin e mbipopullimit në institucion nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, duke marrë masat dhe aktivitetet e duhura dhe duke zbatuar fazën e dytë të ndërtimit dhe rindërtimit;
- Institucioni duhet të përmirësojë kushtet në izolim;
- Të rritet numri i punonjësve në policinë e burgjeve dhe në sektorin e risocializimit;

- Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve të sigurojë pajisje të reja të përshtatshme për policinë e burgjeve;
- Përmirësimi i kushteve në ambientet e "Ndërtësës" dhe "Ambulancës", të cilat janë jashtëzakonisht çnjerëzore dhe degraduese për personat e dënuar, nëpërmjet rikonstruksionit të tyre të plotë ose mbylljes së tyre dhe ndërtimit të një objekti të ri;
- Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe SHNK Idrizovë të marrin masa për heqjen e përhershme të thikave dhe sendeve të tjera të mprehta nga ambientet e personave të dënuar;
- Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe SHNK Idrizovë të ofrojnë kushte për aktivitete falas, sportive, arsimore dhe profesionale për të gjithë të dënuarit, me qëllim kalimin e kohës së lirë cilësore;
- SHNK Idrizovë të mos kryejë segregacion të të dënuarve romë në departamentin e mbyllur të pavijonit të grave;
- Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masa për qasje adekuate në kujdesin shëndetësor për personat e dënuar, përkatësisht:
 - Sigurimi i barnave dhe numri i mjaftueshëm i punonjësve shëndetësorë për të përmirësuar disponueshmërinë dhe aksesin e barnave, shërbimeve të mjekut, psikiatrit, gjinekologjik dhe dentar;
 - Sigurimi në kohë i terapisë adekuate shëndetësore për personat e dënuar dhe përcjellja në institucionet mjekësore;
 - Sigurimi i shiritave për matjen e nivelit të sheqerit në gjakun e personave të dënuar që vuajnë nga diabeti;
 - Sigurimi i terapisë për të gjithë personat për të cilët ka indikacion për mjekim me buprenorfinë ose metadon, pa pagesë nga fondet e tyre por nga programi i varësisë nga Ministria e Shëndetësisë;
 - Përditësimi i të gjitha ndryshimeve në dokumentacionin mjekësor të personave të dënuar, në përputhje me situatën aktuale;
 - Kërkohet monitorim i rregullt (skrining për përdorimin e substancave) dhe vlerësimi i gjendjes së personave që përfshihen në një program trajtimi me opioid nga profesionistët shëndetësorë, jo vetëm gjatë fillimit të terapisë, por rregullisht dhe herë pas here, dhe veçanërisht kur merret një vendim për

reduktimin ose rritjen e terapisë;

- Psikoedukimi është i nevojshëm për personat me varësi në burg;
- Nevojitet ndihmë dhe mbështetje psikosociale për personat e dënuar;
- Ka nevojë për edukim për sëmundjet e varësisë, për trajtimin dhe përfitimet e tij për personat me uniformë dhe për pjesën tjetër të personelit në burg.

Gjendja e krizës

Më 06.06.2023, Qeveria ka miratuar vendim me të cilin është vërtetuar “ekzistenca e gjendjes së krizës në një pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht në zonën e Komunës Gazi Babë, ku Institucioni ndëshkimor-korrektues “Idrizovë” ushtron juridiksionin e saj, me qëllim parandalimin e kërcënimeve të sigurisë dhe forcimin e sigurisë së institucionit”. Organet e administratës shtetërore janë të detyruara të marrin masa dhe aktivitete në përputhje me rregulloren e menaxhimit të krizave, dhe stafi kryesor i menaxhimit të krizave në QMK, të monitorojë situatën, të koordinojë aktivitetet dhe të informojë rregullisht Qeverinë. Gjendja e krizës ka zgjatur 30 ditë, pas së cilës, pas një pushimi prej 2 ditësh, është shpallur sërish gjendja e krizës më 07.07.2023.

Me shpalljen e gjendjes së krizës, anëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Ushtrisë filluan të sigurojnë burgun për mungesë roje. Një nga problemet kryesore me të cilat ballafaqohet “Idrizova” është mungesa e stafit të mjaftueshëm në burg. Numri i punonjësve në policinë e burgjeve është i pamjaftueshëm për të plotësuar nevojat dhe aktivitetet e përditshme. Qeveria ka dhënë pëlqimin për punësimin e 100 efektivëve të rinj të policisë së burgjeve, por ende nuk është marrë pëlqimi nga Ministria e Financave. Gjatë periudhës së krizës është shpallur edhe shpallja për punësim të personave të rinj – pjesëtarë të policisë së burgjeve, dhe pas përfundimit të procedurës do të punësohen 70 persona. Nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve është bërë e ditur se me rebalancën e buxhetit do të krijohen edhe 30 vende pune. Gjithashtu, gjatë krizës u siguruan 40 milionë euro për rindërtimin dhe ndërtimin e një godine të re.

Megjithatë, nuk duhet harruar se ndërkohë që ndërtimi i godinës së re vazhdon, të dënuarit do të strehohen në kushte çnjerëzore dhe nën standarde. Më 27.07.2023, në seancën e 124-të, Kuvendi njëzëri me 62 vota “për” miratoi vendimin për miratimin e vazhdimit të afatit për ekzistimin e gjendjes së krizës në një pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për me qëllim të parandalimit të kërcënimeve të sigurisë dhe forcimit të sigurisë së INK Idrizovë.

Shteti duhet të sigurojë që në veprimet e tij në situatë krize të respektohen standardet ndërkombëtare dhe kjo të mos jetë në dëm të personave të dënuar që vuajnë dënimin me burg në SHNK Idrizovë. Është veçanërisht e rëndësishme që gjendja e krizës të mos zgjatet pafundësisht, veçanërisht sepse bëhet fjalë për mangësi strukturore në institucionet e vuajtjes së dënimit që ekzistojnë prej kohësh, ndaj zgjidhja nuk është shpallja e gjendjes së krizës, por zgjidhja sistematike e problemeve.

SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE SHTIP

Vizita në burg nisi me një bashkëbisedim me drejtorin e institucionit. SHNK Shtip ka 148 vende për akomodimin e personave të dënuar sipas standardeve të CPT-së dhe sipas institucionit kapaciteti është për 210 persona të dënuar. Situata aktuale numerike është 219 persona të dënuar. Në periudhën maj- qershor rreth 30 persona të dënuar janë zhvendosur në institucione të tjera, për të liruar institucionin nga mbipopullimi. Në repartin e mbyllur janë akomoduar 69 të dënuar, në repartin e pritjes 7 të dënuar, në atë gjysmë të hapur 124 dhe në arrati 19 të dënuar. Institucioni po përballet sërish me mbipopullim për shkak të numrit të madh të të dënuarve dhe ambienteve të vogla që ka burgun në përputhje me standardet e CPT-së.

Sa i përket numrit të të punësuarve në institucion, SHNK Shtip ka të punësuar 106 persona, nga të cilët 13 janë zyrtarë administrativë, 93 policë të burgjeve në departamentin e policisë së burgjeve dhe 6 persona në departamentin e risocializimit.

Një nga problemet kryesore me të cilat përballet burgun është pikërisht numri i vogël i punonjësve në postet kyçe për risocializimin e personave të dënuar. Konkretisht në sektorin e risocializimit është reduktuar në dy numri i edukatorëve, të cilët punojnë me të gjithë të dënuarit. Janë shpallur punësime të reja, gjegjësisht janë marrë pëlqimet për punësimin e 8 personave në pozita administrative, nga të cilët 4 persona për risocializim dhe 1 person në policinë e burgjeve. Policia e burgjeve që nga viti 2017 nuk ka pajisje të reja (uniformë, shkopinj, radiolidhje, pranga etj.) dhe ajo që disponon është e pamjaftueshme dhe e paplotë.

Hapësira e përmirësuar që është konstatuar në raportin e mëparshëm nga një vizitë e rregullt është ruajtur, mirëmbajtur në gjendje të mirë dhe të gjitha pajisjet e blera janë funksionale.

Në pjesë të caktuara të burgut u vendosën pllaka të reja, ndërsa gjatë vizitës disa nga dhomat në pavijonin gjysmë të hapur dhe të hapur u rinovuan nga të dënuarit. Ata morën pjesë edhe në ndërtimin e një amfiteatri të hapur dhe një lulishte në oborrin e institucionit, ku ende mungojnë karriget për amfiteatrin. Institucioni ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Shtëpinë e Kulturës së Shtipit, kështu që amfiteatri pritet të kontribuojë në hapësirë për një program kulturor dhe argëtues.

Reparti i mbyllur ndodhet në një ndërtesë të veçantë dhe është tërësisht i ndarë nga pjesa tjetër e hapësirës. Njerëzit kanë një vend të veçantë për të shëtitur.

Ka tre dhoma ndenjeje në çdo kat dhe në një dhomë mund të akomodohen maksimumi 4 persona. Dezinfektimi dhe dezinfektimi kryhen rregullisht në të gjitha krahët, por disa të dënuar ankohen për shfaqjen e teutabiteve. Na u theksua se spërkatet rregullisht kundër insekteve, por mirëmbajtja e higjienës kërkohet edhe nga vetë personat e dënuar, të cilët me kalimin nga një institucion në tjetrin i bartin edhe teutabitetet.

Gjatë vizitës, institucioni është çliruar nga mbipopullimi – në një dhomë, në varësi të madhësisë dhe mundësisë, mund të vendosen deri në 5 të dënuar. Të gjitha dhomat në repartin gjysmë të hapur kanë tavolina dhe karrige uniforme të vendosura nga institucioni, me dritare PVC të sapo instaluara. Në të gjitha dhomat janë vendosur komodina të reja dhe llamba LED. Dyert janë ndërruar dhe një pjesë e ambienteve janë zbardhur dhe disa janë zbardhur gjatë vizitës nga vetë të dënuarit. Gjithashtu, gjatë vizitës në këtë pjesë të objektit janë rinovuar disa nga tualetet.

Për shkak të mbipopullimit dhe mungesës së hapësirës në SHNK Shtip, ndodh që të dënuarit që nuk kanë kundërvajtje disiplinore, të cilët caktohen në krahë të tjerë dhe u lejohet qasja në krahun që u është caktuar, vendosen në izolim. Disa nga personat vullnetarisht kërkojnë të vendosen në këtë seksion. Edhe pse institucioni mendon se kjo praktikë është e mirë dhe në interes të personave të dënuar, sidomos kur është me kërkesë të tyre, ne mendojmë se akomodimi në këto ambiente është poshtëruar dhe çnjerëzor. Ato dhoma nuk ofrojnë asnjë privatësi as për përdorimin e tualetit, as nuk plotësojnë standardet minimale për madhësinë e dhomës, ndriçimin dhe ajrosjen dhe të dënuarit nuk kanë akses të lirë në krahët që u janë caktuar.

Ndryshim pozitiv është se një numër i madh i të dënuarve janë të angazhuar në punë dhe rezultatet e kësaj janë të dukshme, sidomos në oborrin e burgut, ku përveç amfiteatrit, po punohet në të gjitha fushat. Janë të punësuar mbi 60-70 persona të dënuar. Si praktikë pozitive, duhen theksuar aktivitetet bujqësore dhe blegtorale të nxitura nga institucioni. Personat e dënuar merren me përgatitjen e bukës dhe ushqimit, si dhe mbahet higjiena e mirë në mensë dhe kuzhinë. Personat e dënuar nuk janë ankuar për ushqimin, i cili ndërrohet sipas dëshirës dhe nevojave të tyre.

Biblioteka ka një përzgjedhje të madhe librash dhe përdoret nga të dënuarit.

Sa i përket pjesës së arsimit, jemi informuar se personat e dënuar me arsim fillor jo të plotë kanë mundësi ta përfundojnë atë dhe natyrisht të marrin certifikata të ndryshme. Shkollimin fillor e kanë kryer gjithsej 45 persona të dënuar, ndërsa mbi 180 të dënuar kanë marrë vërtetime të ndryshme për profesione.

Në një bashkëbisedim me drejtorin u informuam se korrupsioni në këtë institucion nuk është aq i madh dhe është reduktuar në minimum dhe sanksionohen rëndë të gjithë efektivët e policisë së burgjeve dhe stafi që do të kapen në veprime korruptive.

Gjithashtu nga institucioni u informuam se ka një telefon për komunikimin e të dënuarve me botën e jashtme dhe dy tableta, të cilat duke biseduar me të dënuarit mësuam se ende nuk janë përdorur sa duhet.

Në periudhën prej 01.01. deri më 30.06.2023 ndaj personave të dënuar janë iniciuar 67 procedura disiplinore. Procedurat disiplinore zakonisht i referohen posedimit dhe përdorimit të celularit, sulmit fizik, arratisjes, refuzimit të një urdhri, abuzimit të një privilegji të caktuar. Masa disiplinore më e zakonshme është izolimi, por sipas drejtorit, shumica nuk i vuajnë dënimet disiplinore në tërësi. Lidhur me masat e shqiptuara disiplinore pranë Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve janë parashtruar 7 ankesa. Për përdorimin e mjeteve shtrënguese, mbahet evidencë përkatëse nga institucioni dhe punonjësit.

Të dënuarit i drejtohen drejtorit me një sërë problemesh dhe ankesash dhe shpesh ngatërrojnë të drejtat dhe privilegjet. Gjithashtu, ai pranon për bisedë të gjithë personat e dënuar, në përputhje me kohën dhe detyrat e tij.

Kujdesi shëndetësor

Kujdesi shëndetësor në SHNK Shtip ofrohet nga një mjek dhe një stomatolog, ndërsa është paralajmëruar punësimi i një mjeku tjetër të përgjithshëm. Higjiena dhe rregullitë në ambulancë ruhen në nivelin e duhur. Jemi informuar se personat e dënuar të varur nga droga trajtohen në mënyrë adekuate.

Ndihma juridike

Gjatë vizitës bisedojmë me 10 persona të dënuar të zgjedhur në mënyrë të rastësishme. Një i dënuar u ankua për trajtim joadekuat me ofendime dhe të bërtitura nga një pjesëtar i policisë së burgut.

Rekomandime

- Marrja e masave për eliminimin e mbipopullimit në institucion nga ana e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve;
- Institucioni nuk duhet të akomodojë persona të dënuar në izolim për shkak të madhësisë dhe kushteve të objektit;
- Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve të sigurojë pajisje të përshtatshme dhe të reja për policinë e burgjeve;
- Të rritet numri i punonjësve të policisë së burgjeve dhe stafit të punësuar në sektorin e risocializimit;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Institucioni të marrin masa për qasje adekuate në kujdesin shëndetësor për personat e dënuar, përkatësisht:
 - ofrimi në kohë i terapisë adekuate shëndetësore për personat e dënuar dhe përcjellja e tyre në institucionet mjekësore;
 - Sigurimi i terapisë për të gjithë personat për të cilët ka indikacion për mjekim me buprenorfinë ose metadon, duke mos paguar nga fondet e tyre por nga programi i varësisë nga Ministria e Shëndetësisë;
 - Përditësimi i të gjitha ndryshimeve në dokumentacionin mjekësor të personave të dënuar, në përputhje me situatën/gjendjen aktuale;
 - Kërkohet monitorim i rregullt (skrining për përdorimin e substancave) dhe vlerësimi i gjendjes së personave që përfshihen në një program trajtimi me opioid nga profesionistët shëndetësorë, jo vetëm gjatë fillimit të terapisë, por rregullisht dhe herë pas here, dhe veçanërisht kur merret një vendim për reduktimin ose rritjen e terapisë;
 - Nevojitet psikoedukim për personat me varësi në burg;
 - Nevojitet ndihma dhe mbështetja psiko-sociale për personat e dënuar;
 - Edukimi për sëmundjet e varësisë, trajtimin dhe përfitimet e tij është i nevojshëm për personat me uniformë dhe personelin tjetër të burgjeve.

SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE PRILEP

Vizita në burg filloi me një bashkëbisedim me drejtorin e SHNK Prilep. Kapaciteti i objektit është për 108 persona. Numri i të dënuarve në momentin e vizitës ishte 132. Institucioni po përballet sërish me mbipopullim për shkak të numrit të madh të personave të dënuar, kurse kapacitetet e burgut janë të vogla në përputhje me standardet e KPT-së.

Në institucion janë të punësuar gjithsej 66 persona, nga të cilët 51 janë policë të burgjeve dhe 7 në administratë. Sipas të dhënave që kemi marrë nga institucioni, në sektorin e risocializimit janë të punësuar 8 persona, por në momentin e vizitës jemi njoftuar se në sektorin e risocializimit aktualisht janë të punësuar vetëm 2 persona, që është një numër i pamjaftueshëm për të përmbushur të gjitha detyrat e punës.

SHNK Prilep ka repartin e pritjes, repartin e hapur, repartin gjysmë të hapur, repartin e mbyllur dhe repartin për strehimin e personave të dënuar me rrezikshmëri të lartë.

Personat që i nënshtrohen trajtimit të mbyllur B3 dhe ata në repartin e pritjes, ndonjëherë, për shkak të mungesës së hapësirës së mjaftueshme, vendosen në një hapësirë të përbashkët, gjë që mund të ketë një efekt të dëmshëm për personat e dënuar rishtazi të pranuar dhe për risocializimin e tyre të mëtejshëm.

Në departamentin e mbyllur të institucionit ndodhen dy dhoma me nga 8 dhe 9 krevate secila. Madhësia e dhomave, e cila nuk është më e madhe se 16 m², nuk është adekuate për numrin e të dënuarve që strehohen në to. Në këto dhoma u vu re gjithashtu nivele të shtuara lagështie dhe mure të palyer. Një dhomë në të cilën strehoheshin më parë personat është kthyer në dhomë studimi, për shkak të nivelit të lartë të lagështirës. Tualeti në këtë pjesë ka një nivel dukshëm të ulët të higjienës, me 1 dush dhe 2 lavamanë.

Reparti i pritjes në objekt është me dy dhoma. Higjiena në të ishte e ulët, kurse personat e dënuar qëndrojnë në këto hapësira për një kohë shumë të gjatë, madje edhe për disa vite.

Reparti i hapur dhe gjysëm i hapur në objekt ka gjithsej 15 dhoma, të cilat janë në gjendje relativisht të mirë, të pajisura me krevate, tavolina dhe karrige. Të dënuarit kanë në dispozicion edhe dhomën e kujdesit ditor, si

dhe një bibliotekë të pajisur plotësisht me libra në disa gjuhë. Tualeti në këtë pjesë të objektit është në gjendje dukshëm më të mirë se tualetet e tjera, por higjiena në korridore është në nivele të ulëta të palakmueshme.

Vetë institucioni ka krijuar praktikën e krijimit të një zone izolimi, një repart për të dënuarit me rrezikshmëri të lartë me kapacitet për 8 persona, të cilin e përdorin për personat me procedura disiplinore dhe për personat që shkaktojnë probleme dhe përleshje me të dënuarit e tjerë. Ata nuk kanë një rregullore se sa kohë do të qëndrojnë këta njerëz në këto dhoma. Përballë këtyre dhomave ndodhen 4 qeli izolimi, kushtet e të cilave janë nën standarde. Gjatë vizitës folëm me një person që ndodhej në qeli për disa ditë dhe më pas u transferua në zonën e izolimit. Nuk është kryer procedura formale për kundërvajtje disiplinore dhe personi nuk ka marrë vendimin për caktimin e strehimit në qeli. Në këto dhoma nuk funksiononte sistemi i thirrjeve dhe për të funksionuar të dënuarit lidhin dy tela. Nga 1 janari deri më 30 qershor, ndaj personave të dënuar janë iniciuar 22 procedura disiplinore, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me posedimin dhe përdorimin e celularit, shitjen, sulmin fizik, pjesëmarrjen në përleshje, keqpërdorimin e privilegjit të caktuar – arratisjen dhe për ta më së shpeshti shqiptojnë izolim ose qortime publike. Kundër asnjë vendimi disiplinor nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Pozitive është se janë të punësuar mbi 30 persona të dënuar. Në këtë moment është duke u zbatuar një projekt i mbështetur nga BE-ja e Qendrës për Iniciativa Qytetare, përmes të cilës po pajiset një punëtori bravandreqës dhe një punëtori e teknologjisë informatike. Pas pajisjes së punëtorive do të fillojë procesi i përfshirjes së personave të dënuar me qëllim risocializimin dhe riintegrimin e tyre. Gjithashtu, është pozitiv fakti se në fermën e institucionit janë të angazhuar rreth 15 persona, ku merren me veprimtari blegtorale dhe bujqësore. Ferma realizon të ardhura prej mbi 3.000.000 denarë.

Kujdesi shëndetësor

Kujdesi shëndetësor ofrohet nga dy infermiere të cilat ndodhen në objekt çdo ditë, nga ora 7:30 deri në orën 15:30 dhe në thirrje nëse nevojitet. Infermieret, edhe pse prej 4 vitesh punojnë çdo ditë në institucion, nuk kanë një marrëdhënie të rregullt dhe të rregulluar pune. Një psikiatër vjen

2-3 herë në muaj në institucion dhe sipas nevojës. Personat e dënuar përdorin shërbimet stomatologjike jashtë institucionit. Terapia mjekësore në tërësi sigurohet nga institucioni nga mjetet e veta, por disa barna i blejnë personat e dënuar me recetë të lëshuar më parë. Një numër i madh i personave të dënuar janë të detyruar të blejnë vetë buprenofinë, për faktin se Qendra e Varësisë në Manastir nuk ka kapacitet të mjaftueshëm.

Ndihma juridike

Gjatë vizitës bisedojmë me gjithsej 10 persona të dënuar të përzgjedhur rastësisht, të cilët kërkuan këshilla ligjore në lidhje me të drejtën e lirimit me kusht, përdorimin e privilegjeve, si dhe për aksesin në kujdesin shëndetësor.

Rekomandime

- Marrja e masave për eliminimin e mbipopullimit në institucion nga ana e institucionit dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve;
- Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe SHNK Prilep të bëjnë përpjekje për përmirësimin e kushteve në izolim në mënyrë që të përmbushen standardet e nevojshme;
- SHNK Prilep të standardizojë shfrytëzimin e hapësirës së izolimit që e shfrytëzon në praktikë;
- Të rritet numri i punonjësve në policinë e burgjeve dhe në sektorin e risocializimit;
- Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve të sigurojë pajisje adekuate për policinë e burgjeve;
- SHNK Prilep duhet të bëjë përpjekje në të ardhmen që personat nga reparti i pranimit dhe ata që tashmë kanë marrë trajtim të mos vendosen në dhoma të përbashkëta, ndërsa personat e repartit të pranimit të mos qëndrojnë në këtë pjesë për një kohë të gjatë;
- Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe SHNK Prilep të marrin masa për përmirësimin e kushteve në tualetet në ambientet e mbyllura dhe në receptionin;

- SHNK Prilep të mos akomodojë më shumë persona të dënuar në një dhomë sesa lejohet me ligj dhe sipas standardeve;
- SHNK Prilep të respektojë procedurën e paraparë për dhënien e kundërvajtjes disiplinore dhe dhënien e vendimit;
- Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masa për të përmirësuar aksesin në kujdesin shëndetësor, përkatësisht:
 - Punësimi i një mjeku dhe dy infermiereve të cilët ofrojnë shërbime shëndetësore;
 - Është e nevojshme ofrimi në kohë i terapisë për personat e dënuar dhe përcjellja në institucionet mjekësore;
 - Është e nevojshme që të gjithë personat për të cilët ka indikacion për mjekim me buprenorfinë ose metadon të mos i paguajnë nga fondet e tyre, por nga programi i varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë;
 - Është e nevojshme të dokumentohen të gjitha ndryshimet në dokumentacionin mjekësor që të korrespondojnë me situatën aktuale;
 - Kërkohet monitorim i rregullt (skrining për përdorimin e substancave) dhe vlerësimi i gjendjes së personave të përfshirë në një program trajtimi me opioid nga profesionistë shëndetësorë, jo vetëm kur fillon terapia, por rregullisht dhe herë pas here, veçanërisht kur merret një vendim për të reduktuar ose rritur terapinë;
 - Psikoedukimi është i nevojshëm për personat me varësi në burg;
 - Nevojitet ndihma dhe mbështetja psiko-sociale për personat e dënuar;
 - Ka nevojë për edukim për sëmundjet e varësisë, për trajtimin dhe për privilegjet për personat e uniformuar dhe për pjesën tjetër të personelit në burg.

BURGU KUMANOVË

Vizita në burg filloi me një bashkëbisedim me komandantin e Burgut të Kumanovës. Numri i personave të dënuar në momentin e vizitës është 156 persona të dënuar, prej tyre 12 të dënuar janë në arrati dhe 32 persona në paraburgim. Kapaciteti i objektit është për 220 persona. Në Repartin e hapur në Kriva Pallankë janë 28 persona.

Për sa i përket punonjësve në burg, ai ka 75 pjesëtarë të policisë së burgjeve dhe 27 persona në administratë. Në sektorin e risocializimit janë të punësuar 10 persona.

Institucioni ka një repart të hapur në Kriva Pallankë, si dhe një repart gjysmë të hapur, të mbyllur, repartin e pranimit dhe repartin e paraburgimit.

Në dhomat dhe korridoret e institucionit ndëshkimor-korrektues vërehet një nivel i përmirësuar i higjienës, gjë që nuk mund të konfirmohet për gjendjen e konstatuar në disa dhoma të të dënuarve. Kushtet e tjera në dhoma nuk kanë ndryshuar në raport me gjendjen e përcaktuar nga raporti i fundit. Higjiena dhe aroma në qelitë e izolimit ishte në nivel shumë të ulët.

Institucioni ende përballet me probleme me ujësjellësin dhe gjatë vizitës u njoftuam se kanë ujë nëse kantina e verës e cila ndodhet afër lëshon ujë. Në dhomat e të dënuarve nuk ka ujë dhe në çdo repart ka nga një rubinet. Në tualete dushet kanë qenë funksionale, ndërsa për të gjithë të dënuarit funksionojnë 4 dushe, që është një numër shumë i vogël.

Reparti i pritjes në repartin gjysmë të hapur është shndërruar në dhomë për ritet fetare për nevojat e personave të dënuar.

Shëtitortja për personat e dënuar është krejtësisht në qiell të hapur pa hije dhe pa rekuizita.

Policia e burgjeve nuk ka pajisje të reja (uniformë, shkopinj, radio, pranga etj.) dhe ajo që disponon është e pamjaftueshme dhe e pakompletuar. Ata kanë 30 pranga dhe 8 pistoleta. Punonjësit nuk po përballen aktualisht me ndonjë kërcënim.

Personat e dënuar i drejtohen drejtorit me një sërë problemesh dhe ankesash dhe shpeshherë ngatërrojnë të drejtat dhe privilegjet. Gjithashtu, i merr për bisedë sipas kohës dhe angazhimeve të tij.

Në institucion personat e dënuar të cilët janë të angazhuar merren me kujdestarinë, gjegjësisht mirëmbajtjen e higjienës dhe rregullimin e hapësirave të gjelbra, si brenda institucionit dhe rrethinat e tij, ashtu edhe në vende të tjera që kanë kërkuar një shërbim të tillë nga burgu. Aktualisht janë të punësuar 11 persona në kompani të jashtme dhe ata që janë të interesuar për kujdestarinë, gjegjësisht mirëmbajtjen e higjienës dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra. Disa nga personat e dënuar marrin një kompensim të caktuar monetar për punën e tyre.

Sa i përket risocializimit mund të konstatojmë se aktivitetet që i ndërmerr institucioni për risocializim janë të parëndësishme, kurse personat e dënuar nuk kanë mundësi për aktivitete, gjë që është realisht e papërshtatshme duke pasur parasysh se sipas informacioneve në sektorin e risocializimit janë të punësuar 10 persona. Personat e dënuar nuk kanë ndonjë veprimtari profesionale.

Procedurat disiplinore ndaj personave të dënuar zakonisht i referohen posedimit të telefonave të futur në mënyrë të paligjshme në institucion, si dhe lëndëve narkotike, si dhe mosbindjes ndaj urdhrave, për të cilat vendoset izolimi. Në pjesën më të madhe, personat e dënuar nuk i kryejnë dënimet disiplinore në tërësi. Lidhur me përdorimin e mjeteve shtrënguese, mbahet evidencë e duhur nga institucioni dhe punonjësit.

Kujdesi shëndetësor

Kujdesin shëndetësor në Burgun e Kumanovës e kryen tekniku mjekësor i punësuar në institucion. Mjeku vjen në institucion dy herë në javë, dhe për shkak të largësisë së madhe të institucionit nga qytetet e Kumanovës dhe Shën Nikollës, ndihma emergjente mjekësore nuk mund të arrijë me kohë për t'iu ofruar kujdes shëndetësor personave të dënuar.

Në objekt nuk ka mundësi për trajtimin e të dënuarve të varur me terapi të përshtatshme dhe vetëm një pjesë e vogël e personave të varur nga opiumi në burg marrin terapinë e duhur sipas mjekësisë së bazuar në dëshmi. Këta persona që marrin terapi janë persona që janë transferuar nga objekte të tjera. Në një bisedë me përfaqësues të institucionit na është thënë se kur në institucion vijnë të dënuar të varur nga droga, autoritetet nuk ofrojnë terapi adekuate. Trajtimi joadekuat rezulton në dhunë, zënka, depresion, ankth, autoagresion, tentativa për vetëvrasje, agresion dhe formimin e një

tregu të zi të barnave për trajtimin e varësisë nga mjekësia e bazuar në fakte. Në burg ka edhe drogë - marihuana dhe tableta gjuhësore me buprenorfinë të marra në mënyrë të paligjshme, sipas deklaratave të punonjësve dhe personave të dënuar.

Ndihma juridike

Gjatë vizitës biseduam me gjithsej 10 persona të dënuar të cilët kishin nevojë për këshilla juridike. Problemet më të shpeshta me të cilat përballen kanë të bëjnë me kujdesin e pamjaftueshëm shëndetësor, gëzimin e privilegjeve, transferimin në një institucion tjetër penitenciar, procedimet e tjera penale, etj.

Rekomandime

- Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, së bashku me Burgun e Kumanovës, të gjejnë zgjidhje për problemin e furnizimit me ujë;
- Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve duhet të bëjë përpjekje për rinovimin e shëtitorës për personat e dënuar në repartin e mbyllur, me synimin për më shumë kushte për kohë të lirë cilësore;
- Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Burgu i Kumanovës të sigurojnë kushte për aktivitete të lira, sportive, edukative dhe profesionale për të gjithë personat e dënuar me qëllim kalimin e kohës së lirë cilësore;
- Burgu i Kumanovës të ndërmerr veprime për përmirësimin e higjienës në institucion;
- Rritja e numrit të punonjësve të policisë së burgjeve dhe personave në sektorin e risocializimit;
- Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve të sigurojë pajisje të përshtatshme dhe të reja për pjesëtarët e policisë së burgjeve;
- SHNK Kumanovë të trajtojë dhe veprojnë në mënyrë adekuate me personat e dënuar të varur nga droga në përputhje me mjekësinë e bazuar në dëshmi;

- Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masa për të përmirësuar aksesin në kujdesin shëndetësor, përkatësisht:
- Rritja e numrit të punëtorëve shëndetësorë me qëllim të ofrimit të kujdesit adekuat shëndetësor;
 - Është e nevojshme ofrimi në kohë i terapisë për personat e dënuar dhe përcjellja në institucionet mjekësore;
 - Është e nevojshme që të gjithë personat për të cilët ka indikacion për mjekim me buprenorfinë ose metadon ta marrin duke mos paguar nga fondet e tyre, por nga programi i varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë;
 - Është e nevojshme të dokumentohen të gjitha ndryshimet në dokumentacionin mjekësor, në mënyrë që të korrespondojnë me situatën aktuale;
 - Kërkohet monitorim i rregullt (skrining për përdorimin e substancave) dhe vlerësimi i gjendjes së personave të përfshirë në një program trajtimi me opioid nga profesionistë shëndetësorë, jo vetëm kur fillon terapia, por rregullisht dhe herë pas here, veçanërisht kur merret një vendim për të reduktuar ose rritur terapinë;
 - Psikoedukimi është i nevojshëm për personat me varësi në burg;
 - Nevojitet ndihma dhe mbështetja psiko-sociale për personat e dënuar;
 - Ka nevojë për edukim për sëmundjet e varësisë, për trajtimin dhe përfitimet e tij për personat me uniformë dhe për pjesën tjetër të personelit në burg.

RAPORT MBI
**GJENDJEN DHE KUSHTET NË
INSTITUCIONET NDËSHKIMORE
-KORREKTUESE NË VITIN 2023**

në bazë të vizitave vijuese në
SHNK Idrizovë, SHNK Shtip,
SHNK Prilep dhe Burgun Kumanovë,
për periudhën maj - qershor 2023